



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 532/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

### **VENDIM**

**HIDHEN** poshtë si të palejuara ankesat subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV), përkatësisht me date 13. 12. 2010 dhe numër lende A532 dhe A534

### **ARSYETIMI**

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar 2 (dy) ankesa me numër lende A532 dhe A534 nga subjekti politik LVV përkundrejt KQZ-se, në të cilat parashtruesi pretendon respektivisht se:

A532- Në QV 1103b/01, Mitrovicë, dt. 12.12.2010, ora 10:00, “llampat ultravjollce të identifikimit të gishtave nuk kanë qenë funksionale dhe gjate kësaj periudhe kohore kanë votuar kater deri në pesë persona”; është bërë shkelje e nenit 7 paragrafi 1 pika (a) të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë, me përjashtim të dy numrave telefoni të cilët i përkasin Rushit Pecit dhe Ilir Ahmetit;

A534- “Në VV nr. 1105/01R në shkollën fillore “Skenderbeu”, Mitrovicë, nga ora 09:00-10:00 ka pasur probleme me mosfunksionimin e llampave identifikuese, gjithashtu ka pasur edhe probleme me shiritat e kutisë nr. 320041, 320042, 320043 dhe 320043”. Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka paraqitur asnjë provë, përveç se ka siguruar emrin e Medijana Rrahmanit anëtare të LDK-se;

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshtë:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.3 dhe 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

*6.3 “Me qëllim të lehtësimit të shyrtimeve të ankesave, kryesuesi i panelit mund të vendosë ta bëjë bashkimin e ankesave që përfaqësojnë në vetë çështje të ngjashme, paneli vendimmarrës i trajton ato si kur të ishin një ankese”.*

*6.4 “Panelet mund të refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo atë të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie”.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**-ankesat janë të palejuara**

PZAP-i vlerëson se ankesat e LVV-se paraqitur përkundërt KQZ-se janë jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjatë procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa**

A nr. 532/2010 më datën 15.12.2010.

